U D H Ë Z I M
Nr.8, datë 2.10.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.3, DATË 21.6.1993 "PËR ZBATIMIN E LIGJIT "PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE ISH-PRONARËVE""

Në mbështetje të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", me propozimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

1. Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 21.6.1993, në pikën 1, pas paragrafit 6 të shkronjës "Ç" shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Përfitojnë trajtim sipas këtij ligji edhe ata ish-pronarë, të cilëve u janë dhënë troje, toka bujqësore ose jobujqësore me kufizim "ndalim shitje" deri në 15 vjet sipas ligjit të vitit 1932 "Për vendosjen e emigrantëve" dhe ligjit të vitit 1935 "Për reformën agrare", kur nga akti noterial i kësaj pronësie rezulton se prona u është akorduar kundrejt pagesës dhe gjithnjë kur plotësohen kushtet që përcaktohen në nenin 1 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993.

Po kështu të trajtohen edhe rastet kur qeveria e viteve 1924-1939 u ka akorduar nëpunësve të shtetit truall falas për ndërtim banese, me kusht që brenda një periudhe të caktuar kohe të ndërtonin banesën, kur nga akti hipotekor i kësaj pronësie nuk rezulton që trualli t'u jetë hequr deri në datën 7 prill 1939".

2. Në paragrafin 2 të pikës 15 shfuqizohet fjalia: "Në rast se gjykata rivendos afatin kohor, atëherë rikthimi do të bëhet me kompensim me obligacione".

3. Pas paragrafit 2 të pikës 15 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kërkesat për njohjen e së drejtës së kthimit ose kompensimit të pasurive të paluajtshme të konfiskuara që janë paraqitur dhe regjistruar në bashkitë e vendit në zbatim të shkronjës "d" të nenit 5 të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", konsiderohen se janë brenda afatit ligjor sipas nenit 22 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993. Këto kërkesa, së bashku me aktet për pasurinë e paluajtshme, bashkitë duhet t'ia dërgojnë me shkresë komisionit përkatës për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve. Çdo ish-pronar i përndjekur politik, krahas plotësimit të dokumentacionit që kërkohet nga ligji dhe aktet nënligjore, duhet të bëjë edhe pagesën prej 2000 lekësh, siç është përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi